



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Komuna e Prishtinës
Pristina Obstina-Municipality of Pristina



SEKTORI I PROKURIMIT - KABINETI I KRYETARIT

Bazuar në nenin 108/A paragrafi 10 nënparagrafi 10.2 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik lidhur me nenin 60 të Ligjit nr. 05/L-068 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin nr. 04/L-237 dhe me ligjin nr. 05/L-092, si dhe duke u bazuar në nenin 61.3. lidhur me nenin 62 paragrafi 62.1 nënparagrafi d) si dhe nenin 63 paragrafi 63.1 nënparagrafi 63.1.1 të Rregullores (A01) nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, duke vendosur sipas kërkesës për rishqyrtim të operatorit ekonomik "NT BITI-COM" të datës 15.09.2025 kundër njoftimit mbi vendimin lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Ndërtimi i Parqeve dhe Hapësirave Gjellbëruese" me nr. të prokurimit 616-25-7012-5-2-1, Komuna e Prishtinës (autoriteti kontraktues) përmes zyrtarit përgjegjës të prokurimit nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. **REFUZOHET** kërkesa për rishqyrtim e operatorit ekonomik "NT BITI-COM" të datës 15.09.2025 kundër njoftimit mbi vendimin lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Ndërtimi i Parqeve dhe Hapësirave Gjellbëruese" me nr. të prokurimit 616-25-7012-5-2-1.
- II. **AUTORIZOHET** autoriteti kontraktues - Komuna e Prishtinës që të vazhdoj me aktivitetin e prokurimit të përcaktuar si në pikën I të këtij vendimi.
- III. **NJOFTOHEN** palët e interesuara lidhur me këtë vendim përmes publikimit në platformën elektronike E-Prokurimi në adresën <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.
- IV. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

Arsyetim

Operatori ekonomik "NT BITI-COM" (tutje "parashtruesi") me datë 15.09.2025 ka paraqitur kërkesë për rishqyrtim kundër njoftimit mbi vendimin lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Ndërtimi i Parqeve dhe Hapësirave Gjellbëruese" me nr. të prokurimit 616-25-7012-5-2-1.

Gjatë shqyrtimit paraprak të kërkesës për rishqyrtim të parashtruesit është gjetur se kërkesa është e lejuar dhe është parashtruar brenda afatit nga personi i autorizuar si dhe nuk ekzistojnë pengesa tjera për të shqyrtuar kërkesën e parashtruesit. Në këtë mënyrë janë plotësuar kushtet për të vazhduar me shqyrtimin meritore (*in meritum*) të kërkesës.

Pretendimet ankimore të parashtruesit:

“Të gjitha kontratat dhe raportet që kemi dorëzuar janë dokumente zyrtare të lëshuara nga institucionet e Kosovës, në përputhje me nenet 59 dhe 61 të LPP. Dokumentet janë të vlefshme dhe mund të verifikohen në çdo moment nga Autoriteti Kontraktues, duke konfirmuar se kontratat janë realizuar sipas kushteve të kërkuara dhe se vlera totale e kontratave të dorëzuara (507,341.21 Euro €) përmbush kriterin minimal. Sipas LPP, autoriteti kontraktues nuk mund të eliminojë një operator ekonomik kur provimet e kapacitetit ekonomik dhe teknik janë të ligjshme dhe të verifikueshme. Referencat dhe raportet tona përbëjnë provë të besueshme dhe zyrtare, dhe çdo argument për eliminim që bazohet vetëm në mungesën e një dokumenti ndihmës të paplotë është interpretim formal dhe jo ligjor. Institucionet që kanë lëshuar dokumentet mund të kontaktohen për verifikim të të dhënave, por kjo nuk duhet të shërbejë si arsye për eliminim kur kriteret janë plotësuar”.

Sipas letrës standarde për tenderuesin e eliminuar, parashtruesi është shpallur si tenderues i papërgjegjshëm dhe është eliminuar për arsye si në vijim:

Ju si OE-ik me oferte financiare me qmim të poentua prej: 890.80 EUR Komisioni, pas shqyrtimit, analizimit dhe krahasimit të ofertës me kërkesat e njoftimit për kontratë dhe dosjes së tenderit, konstaton se ky operator nuk është i përgjegjshëm, pasi nuk ka arritur të dëshmojë përmbushjen e kërkesave teknike dhe/ose profesionale sipas pikave 9.1 dhe 9.2 – Kapaciteti teknik dhe profesional, konkretisht:

1. Operatori ekonomik ose grupi i Operatoreve Ekonomik duhet të ofrojë dëshmi se ka përfunduar me sukses projekte të ngjashme në tri vitet e fundit nga data e njoftimit për kontratë së paku në vlerë prej 450,000.00 €, Dëshmia e kërkuar dokumentare

1. Lista e projekteve të realizuara për punë të ngjashme në tri vitet e fundit e cila duhet të përmbajë punët e përfshira; shumën e kontratës; datën dhe pranuesin e dëshmuar me “Referencë” ose “Raport” për realizimin me sukses të Kontratës. (i) Kur furnizimi është bërë për një autoritet publik në Kosovë ose në një vend tjetër, për dëshmi të këtij shërbimi shërben kopja e certifikatës (certifikatave) të rëndësishme të lëshuar ose të bashkë nënshkruara nga autoriteti i tillë; (ii) Kur furnizimi është bërë për një blerës privat, për dëshmi të këtij shërbimi shërben kopja e çdo dokumenti të nënshkruar nga blerësi dhe evidentimi i punës të tillë si dhe dëshmia për kryerjen e pagesës (transaksioni bankar, fatura etj). Prandaj, oferta e juaj është e papërgjegjshme.

Lidhur me pretendimet ankimore të parashtruesit sa i përket arsyeve eliminuese të prezantuara në letrën standarde përmes të cilit parashtruesi është eliminuar si i papërgjegjshëm, është gjetur që arsyet e evidentuara nga komisioni vlerësues për eliminimin e parashtruesit si të papërgjegjshëm janë të sakta, të matshme dhe të ligjshme. Rrjedhimisht është gjetur se eliminimi i parashtruesit është bërë në mënyrë të drejtë.

Nga sa u tha më sipër është gjetur se parashtruesi nuk ka paraqitur argumente të qëndrueshme për të mbështetur pretendimet e tij. Prandaj kërkesa për rishqyrtim e parashtruesit është refuzuar si e pabazuar në tërësi.

Për pikën I dhe II të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 par. 63.1.1. nënparagrafin b) lidhur me nenin 62 par. 62.1. nënparagrafin d) të Rregullores nr. 001/2022 për Prokurimin Publik.

Për pikën III dhe IV të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 par. 63.2. të Rregullores nr. 001/2022 për Prokurimin Publik.

Bazuar në të thënat më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Prishtinë, 16.09.2025

Visar SHEHU

Udhëheqës i Sektorit të Prokurimit
Komuna e Prishtinës

Këshillë juridike:

Pala e pakënaqur me këtë vendim mund të paraqes ankesë pranë Organit Shqyrtues të Prokurimit brenda afatit prej dhjetë (10) ditëve pas pranimit të këtij vendimi.